



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 713, Datë 15.10.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Pala Blerëse: Euroimpex d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut. Euroimpex d.o.o. është shpërndarës i markës Peugeot kryesisht në territorin e Maqedonisë së Veriut dhe realizon të ardhura edhe në Shqipëri e Kosovë.

Pala Shitëse: Opel Southeast Europe LLC, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Shitësi vepron si importues dhe shpërndarës i automjeteve Opel si dhe pjesëve të këmbimit, pajisjeve shtesë dhe aksesorëve për markat Opel dhe Chevrolet, në territorin e Evropës Juglindore. Shoqëria realizon të ardhura në Shqipëri.

Target: Opel Automotive S d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Serbisë. Targeti është një ndërmarrje me qëllime të veçanta e themeluar dhe e zotëruar nga Opel Southeast Europe LLC, në vitin 2020 për qëllime të këtij transaksioni. Aktiviteti kryesor i Opel Automotive S d.o.o. do të jetë tregtimi i automjeteve dhe mjeteve motorike të lehta, shitje me pakicë e pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve për mjete motorike etj. Targeti nuk ka filiale ose degë në Shqipëri.

Më datë 04 Shtator 2020, midis palës blerëse Euroimpex d.o.o. dhe palës shitëse Opel Southeast Europe LLC është nënshkruar “Marrëveshja e blerjes së aksioneve”.

Sipas kësaj marrëveshjeje, shitësi Opel Southeast Europe LLC zotëron të gjitha aksionet e targetit Opel Automotive S d.o.o. Shoqëria target nuk kryen asnjë aktivitet tregtar por shitësi do të transferojë tek target Biznesin e Synuar para mbylljes së transaksionit.

Biznesi i Synuar konsiston në importimin dhe shpërndarjen e makinave të markës Opel (Opel dhe Chevrolet) pjesëve të këmbimit, pajisjeve dhe aksesorëve dhe shërbime të tjera të ngjashme, të transferuara nga Shitësi tek Targeti.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Opel Automotiv S d.o.o. do të operojë në tregun e importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve të markës Opel (Opel dhe Chevrolet)

Euroimpex d.o.o. operon në tregun e importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve të markës Peugeot.

Mjetet e transportit dhe pjesët e këmbimit Peugeot të cilat importohen në Shqipëri nga Euroimpex me bazë në Maqedoninë e Veriut dhe mjetet e transportit dhe pjesët e këmbimit Opel të cilat importohen në Shqipëri nga Opel Southeast Europe LLC, me bazë në Hungari me zyre përfaqësimi në Serbi, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë pjesë e Grupit PSA, sot Stellantis.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS